



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-32051/24 datë: 17.12.2024



Npi – 01/410 datë: 17.12.2024

Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 32, dhe 37 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015 të datës 28.12.2015; Si dhe në bazë të nenit 4 dhe 6 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Kryesuesi i Kuvendit vendosi të bëjë këtë:


F T E S Ë

PËR MBLEDHJEN E -XII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E cila do të mbahet në sallën e Kuvendit më: 24.12.2024 (e martë) Në ora: 09:00h

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.11.2024,
2. Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planin për Integritet Npi-01-157 të datës 27.04.2023,
3. Propozim-Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKSB,
4. Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II-të i Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes,
5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit dhe Orarit të mbledhjeve për vitin 2025.
6. Pyetje – Përgjigje.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi



Npi – 01/391 datë: 29.11.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 29.11.2024, është nxjerrë:

E K S T R A K T **P R O C E S V E R B A L**

I Mbledhjes së -XI-të, të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
mbajtur më datë 29.11.2024 (e premte), në ora 09:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kuvendit, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Asistente e Kryesuesit të Kuvendit znj.Gentiana Mehmeti; Zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi; Nga Zyra për Informim; znj.Vlora Hyseni dhe z.Albion Shabani; Zyrtarë i TI-së, z.Shpëtim Gashi; Nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha;

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 31.10.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (pas diskutimit publik)
3. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (pas diskutimit publik)
4. Propozim-Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale,
5. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale,
6. Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit të punës dhe Orarit të mbledhjeve për 2025,
7. Informatë nga DSHMS (Me theks të veçante Kanceri i Gjirit).
8. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje, sot kemi marrë lajmin për vdekjen e sportistes së mirnjohur Nebahate Braha-Gashi, e cila ishte një hendbolliste e talentuar e Klubit "Vjosa" të Shtimes. Me këtë rast ju ftoj që në shenjë nderimi të mbajmë një minutë heshtje.

(Kuvendi mbajti një minutë heshtje për nder të sportistes Nebahate Braha-Gashi)

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Ngushllime families Braha dhe Gashi. Pajtoj me pikat e rendit të ditës përveç pikës 4 që ka të bëjë me vendimin paraparak. Unë kam një pyetje se a është plotësuar Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale, me anëtarin përfaqësues nga OJQ-të? Dhe e dyta unë propozoj një pikë shtesë të rendit të ditës "Informatë për Ujësjetllësin e fshatit Rashincë"

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Sa i përket pyetjes së Reshatit për emrin e anëtarit të Komisionit, po e kemi emrin në vendim dhe vendimi është dërguar në Ministri me emrin e Imer Tërshanit përfaqësues i Bizneseve në Komunën e Shtimes. Ashtu edhe qysh kemi thënë se vendimin do ta dërgojmë në Ministri me emrin e përfaqësuesit të organizatave jo qeveritare, mirpo vlerësim të ligjshmërisë ende nuk kemi nga MAPL-ja. Lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës, po sçaroj se me Ligj jemi të obliguar që për me dhënë një pronë komunale në shfrytëzim, Kuvendi duhet me marrë një vendim paraparak, se cilën pronë dëshiron me dhënë në shfrytëzim, dhe pastaj me bërë njoftimin publik për këtë.

z.Gzim Haxhiu: Përshëndetje. Unë sot kam vendosur që të jap dorheqje, nga Lëvizja Vetëvendosje. Ky vendim nuk është i lehtë për mua. Kontributin tim në Kuvend do ta jap si anëtar i pavarur.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Ngushllime për familjen Braha dhe Gashi. E mora fjalën për të shprehë lavdatë për Gzimin, për hapin e marrë për tu larguar nga Vetëvendosja. Për sa i përket pikave të rendit të ditës, unë jam që pika shtesë "Diskutim për ujësjetllësin e fshatit Rashincë" të futet në rendin e ditës. Unë kam edhe diçka, të futet edhe një pikë shtesë për Arsimin.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. E përgëzoj Gëzimin për largimin nga Vetëvendosja, i cili nuk munda ti përballojë padrejtësitë, për të cilat unë i kam thënë në fillim. Pikërisht moszgjedhja e drejtorëve është shembulli i keq. Pajtoj me pikat por nuk është përfillë plani i punës së Kuvendit. Nuk e kemi informatën nga KRM "Pastërtia". Pastaj duhet me diskutu edhe për ujësjetllësin e fshatit Rashincë. Te pika e 4 e rendit të ditës, ne e kemi zgjedhur Komisionin, ne nuk jemi kundër për me i dhënë pronat komunale në shfrytëzim.

z.Hamëz Tërshani: Përshëndetje. Ngushllime për familjen Braha dhe Gashi. Për mua është me rëndësi që të diskutohet për Rashincën, si dhe pika "Pyetje-Përgjigje" me qenë në rendin e dytë. Për shkollat kisha dëshirë që me qenë prezent edhe drejtoresha e Arsimit dhe pastaj me diskutu.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Ngushllime për familjen Braha dhe Gashi. Rasti i Gzimit më preku shumë, sepse e tha vetë se gjendet në një gjendje të rëndë. Pika e dytë duhet të jetë "Pyetje -Përgjigje".

z.Lumni Amrushi: Përshëndetje. Ngushllime për familjen Braha dhe Gashi por edhe kolegëve në sport. Pajtohem me pikat e propozuara, por duhet të diskutojmë edhe për problemin e fshatit Rashincë me ujësjetllësin. Drejtoresha e arsimit mungon, me pas qenë prezent do të diskutojmë për arsimin, sepse që një kohë të gjatë një shkollë është pa drejtor, prandaj pikën e arsimit do ta diskutojmë në një mbledhjet tjetër të radhës.

z.Besnik Seferi: Unë kërkoj një pauzë prej 15 minutave për ti diskutuar propozimet që u dhanë për pikat shtesë.

z.Rexhep Gashi: Pas diskutimeve që u bënë si pikë shtesë mbeti vetëm propozimi për të diskutuar për ujësjetllësin e Rashincës, prandaj mendoj se nuk ka nevojë për pauzë.

z.Përparim Ramusa: Për me artikulu qartë, propozimi është që si pikë shtesë të futet "Diskutim për ujësjetllësin e fshatit Rashincë" si pikë e dytë e rendit të ditës, dhe pika "Pyetje – Përgjigje" të jetë si pikë e tretë e rendit të ditës.

z.Reshat Mujota: Pajtoj me propozimin e Përparimit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Do të shkojmë për 10 minuta pauzë, për konsultime me grupin parlamentar të Vetëvendosjes.

(Pauza)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Vazhdojmë në ora 10.11h. Në vazhdim Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Lidhur me rendin e ditës janë shterruar diskutimet, kështu që unë do ta qes në votim rendin e ditës ashtu qysh ka ardhur, sipas

Rregullores së punës së Kuvendit, dhe nëse nuk miratohet atëherë e qesim në votim me propozimet e bëra.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes me 10 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim", Kryesuesi votoi "Për" duke e përdorë të drejtën e votës së dyfishtë në rast të rezultatit të barabartë, bazuar në nenin 48 të LVL-së, prandaj me 11 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim", miratoi rendin e ditës.

Kryetari, z.Qemajl Aliu: Përshëndetje. Dua të jap disa sçarime lidhur me investimet në ujësjellës në fshatin Rashincë. Kemi pas takim me banorët e fshatit Rashincë, dhe unë i kamë garantuar se uji i pijes nga pusët në Rashincë fillimisht do të sigurohet për banorët e fshatit Rashincë, për më tepër edhe për vendbanimet tjera, sepse ne jemi të obliguar që ujin e pijes ta sigurojmë për të gjithë banorët e komunës tonë. Po ashtu i kam siguruar se nëse eventualisht do të ketë shterrje të puseve individuale të banorëve për arsye të ndikimit të këtyre puseve të ujësjellësit, unë vetë do ta mbylli rubinetën e gypit të ujësjellësit të fshatrave të rraafshit. Nuk ka nevojë me e politizuar këtë çështje. Për sa i përket çështjes të sigurimit të druve për ngrohje për shkollë, e vërteta është se edhe komunat tjera kanë pasë problem, te ne dy herë ka dështuar sigurimi i kontratës, kështu që e kemi lidhë një kontratë të përkohshme për ti siguruar drutë për shkollë. Lajmet dashakeqe se nuk ka dru për shkollë po përhapen shpejt, por një gjë është e vërtetë se kjo nuk ka ndodhë dhe nuk do të ndodhë asnjëher me neve, kemi pas dru nga vitet e kaluara dhe tani kemi siguruar mjaftueshëm, kështu që banorët e komunës tonë nuk duhet të shqetësohen fare për këtë problem. Sa i përket rastit të Nebahate Braha-Gashi që e kemi pranuar lajmin që ka ndërruar jetë, unë në emër të Komunës së Shtimes i kam dërguar një telegram ngushëllimi, por edhe nga këtu u shprehu ngushëllimet tona të sinqerta dy familjeve Braha dhe Gashi.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 31.10.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota: Kamë vërejtjet e mia në procesverbalin e mbledhjes së kaluar sepse nuk janë përfshi diskutimet e mia, kur është hapë mbledhja e Kuvendit, prandaj unë nuk do ta votoj këtë Ekstrakt – Procesverbal.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 15 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 4 vota "Abstenim" miratoi Ekstrakt-Procesverbalin e Kuvendit nga mbledhja e mbajtur më 31.10.2024.

Pika 2

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025. (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ia jap Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Është mbajtur diskutimi publik sipas vendimit të Kuvendit. Kemi disa propozime konkrete, sit e DSHP-ja janë propozuar tarifa të reja të përshkallëzuara për sa u përket kompanive që e shfrytëzojnë gurin si dhe për guroret. Meqenëse materialin e keni marrë, mund ti shikoni tarifat e propozuara. Pastaj te DZHE-ja lidhur me pëlqimet që janë lëshuar sipas nenit 7 të rregullores tanë kanë kaluar në nivelin qendror, dhe tani hiqen nga rregullorja. Kemi edhe propozime për disa tarifa të reja te DKRS-ja lidhur me shfrytëzimin e hallës sportive. Propozimet e reja për tarifa mund ti shikoni në draftin final të rregullores për tarifa të cilën e keni pranuar, kështu që nëse ka ndonjë pyetje do të përpiqem të përgjigjem. Ju ftaoj që rrugulloren për taksa për vitin 2025 ta miratoni.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit për sçarimet. Këtë rregullore të vitit 2025 e kemi për obligim ligjor për me e miratuar. Unë propozoj që te administrata tarifat që kanë të bëjnë me dëshmitë e vdekjeve me u liru nga pagesa. Po ashtu propozoj që me u liru nga pagesa për fardo shërbimi administrative personat nën moshën 18 vjeçare.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. E falënderojmë drejtorin për rregulloren. Draft rregullorja për taksa për vitin 2025 ka qenë në diskutim publik ku edhe ka pas disa propozime për ndryshimin e tarifave. Ne e përkrahim dhe do ta votojmë.

z.Valon Januzi, drejtor i Administratës; Përshëndetje, sqarim lidhur me propozimin për disa lirime nga pagesa të disa kategorive. Tarifat janë të rregulluara me ligjin për gjendjen civile. Mund të them se shërbimet që mund ti marrin nga E-Kosova janë falas.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Kemi diskutuar gjatë edhe në KPF-ë, po ashtu kemi pas bashkpunim për këtë çështje edhe me komunat tjera, dhe kemi ardhur në përfundim se për shkak të ligjit nuk mundet me u hjekë këto tarifa.

z.Hamëz Tërshani: Edhe nëse ne e kalojmë propozimin e Përparimit, na e kthen prapa MAPL-ja. Sa i përket shërbimeve nga E-Kosova, pyetja është se sa njerëz dine me punu me këtë platformë dhe me I shfrytëzuar këto shërbime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 vota "Për", me 9 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstënim" miratoi Rregulloren Komonale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025.**

Pika 3

Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28,
(pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ia jap Mimoza Salihu-Qeriqi.
znj.Mimoza Salihu-Qeriqi drejtoresh e DSHMS: Përshëndetje. Është mbajtur diskutimi publik më 15 Nëntor 2024, sipas vendimit të Kuvendit. Nuk kemi pas propozime konkrete. Procesverbalin për procesin e diskutimit publik e keni pranuar dhe e keni lexuar. Kështu që nëse ka ndonjë pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur. Ju ftoj që ta miratoni këtë Strategji dhe Plan të Veprimit, sepse përveq tjerash është në interes të kategorisë të personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimitisht miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në komunën e Shtimes 2025-2028.**

Pika 4

Propozim-Vendim Paraparak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Siç e dini ne e kemi listen e pronave të paluajtshme komunale për me i dhënë në shfrytëzim afatgjatë. Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë Ngastrën Kadastrale me numër: P-72809023-00333-16, me sipërfaqe prej: 2894m², në Zonën Kadastrale – Davidovc, sipas Ligjit nevojitet që Kuvendi i Komunës me marrë një vendim paraparak për ta dhënë këtë pronë në shfrytëzim. Kështu që ju ftoj që ta miratoni këtë vendim, meqenëse edhe Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht e ka votuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimitisht miratoi Vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën Komonale, në Ngastrën Kadastrale me numër: P-72809023-00333-16, me sipërfaqe prej: 2894m², në Zonën Kadastrale – Davidovc,**

Pika 5

Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Kemi një kërkesë Nga (KBI) Këshilli i Bashkësisë Islame dega në Shtime, për të ju ndarë një parcelë prej 20 ari për ndërtimin e një Xhamije të re në Shtime. Ne si drejtori e kemi shqyrtuar një mundësi të tillë dhe kemi ardhur në përfundim se mundemi me ja propozuar Kuvendit për Miratim dhënjen në shfrytëzim 20 ari sipërfaqe në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr: P-72809093-03052-3-16, Zona Kadastrale – Shtime, për ndërtimin e Xhamisë së re në Shtime e cila do të jetë në shërbim të komunitetit fetar të besimit

Islam. Lokacioni gjendet në rrugën "Komandant Kumanova" Këtë propozim e ka miratuar edhe Komiteti për Politikë dhe Financa, kështu që ju ftoj që edhe ju ta miratoni.

z.Përparim Ramusa: Ne jemi pro që prona komunale ti epei në shfrytëzim KBI-së në Shtime, për ndërtimin e Xhamisë.

z.Muhamet Ademaj: Edhe ne e përkrahim këtë propozim për me ja dhënë 20 ari ponë Komunale KBI-së në Shtime për me ndërtuar Xhaminë.

znj.Adelina Beqaj: Ne si opozitë për këtë jemi "për" jo sikurse ju që e keni lëshuar mbledhjen.

z.Besnik Seferi: Desha ti tregoj Adelinë se në fund të vitit 2021 janë diskutuar 5 prona komunale në Davidovc për me u dhënë në shfrytëzim dhe ne kemi qenë "Për". Kështu që edhe për këtë të sotit ne jemi "Për" dhe do ta votojmë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite pa kompensim, sipërfaqen prej 2000m² (20 ari) Truall për ndërtimin e Xhamisë së re në Shtime, në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr:P-72809093-03052-3-16; Zona Kadastrale - Shtime. Evidentuar pronë e "Komuna e Shtimes".**

Pika 6

Formimi i Grupit Punues për hartimin e Planit të punës dhe Orarit të mbledhjeve për 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Siç e dini për çdo vit ne duhet ta bëjmë planin e punës së Kuvendit dhe orarin e mbledhjeve. Sot duhet ta formojmë grupin punues, prandaj j ulus që ti propozoni emrat e kandidatëve.

z.Besnik Seferi: Unë e propozoj Sanije Sadikun.

z.Hamëz Tërshani: Unë e propozoj Adelina Beqaj.

z.Muhamet Ademaj: Në emër të LDK-AKR unë e propozoj Rrezartë Ramadanin.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 18 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës dhe Orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit për vitin 2025, në këtë përbërje: 1.Sanije Sadiki, - (LVV), 2.Rrezartë Ramadani, - (LDK), 3.Adelina Beqaj, - (PDK).**

Pika 7

Informatë nga DSHMS (Me theks të veçantë Kanceri i Gjirit)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Mimoza Salihu-Qeriqi.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS: Përshëndetje. Duke u bazuar në Planin e Punës së Kuvendit sot po e paraqesim Informatën e Drejtoris për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me theks të veçantë Kanceri i Gjirit. Informatën ne e kemi përgatitur për Kuvendin dhe ua kemi dërguar me e-mail. Sa i përket Subvencioneve në këtë drejtori sivjet I kemi pas 369 kërkesa. Në vazhdim drejtoresha e lexoi Informatën (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje do të përpiqem që të përgjigjem.

znj.Adelina Beqaj: Pyetja e pare është, qyshë e gjete drejtorinë kur ke ardhur së pari. E dyta pse QKMF-ja dhe QPS-ja janë me ushtrues detyre? Një punëtorë i QPS-së është marrë pa konkurs, dhe pse nuk ka përgjegjës në QPS-ë në Shtime.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit për sqarimet. Ti e ke marrë detyrën frik, prandaj unë po u drejtohem qytetarëve për dështimet në shëndetësi, edhe pse Kryetari vetë është mjek. Si mundet me qenë prioritet shëndetësia kur 4 drejtorë i ka ndrruar në shëndetësi. Menaxhim i dështuar në të gjitha drejtimit. Ka premtuar objekte shëndetësore ndërkaq që asnjë objekt shëndetësor nuk e ka në fshatra. Sa specialistë të mjekësis familjare i ka në QKMF-ë. Ky e ka vazhdu dhe e ka zgjeru kontratën me Karitasin. Nuk ka sistem informativ shëndetësor. Nepotizëm e punësime familjare, menaxhim i dobët i prokurimit. Lifti nuk ka punuar, mungojnë mjetet higjienike. Vitin e kaluar e kemi votuar blerjen e një Autoambulance, që 11 muaj paret i kanë dhe nuk kanë arritë me ble një Autoambulancë. Ku është i përfshirë Davidovci, dhe unë po besoj se është një gabim Teknik. Këto vërejtje ja drejtova Kryetarit.

z.Muhamet Ademaj: E përgëzoj drejtoreshën për punën e mire. Kam një pyetje për drejtoreshën, se si është gjendja me QMF-në e fshatit Petrovë?

z.Lumni Amrush: Faleminderit drejtoresh për informatën. Oborri i QMF-së është rregulluar dhe po ua përkujtoj se aty në atë pjesë është mire me bërë një parking për atomjete, sepse ajo pjesë është e pa shfrytëzuar. Mundesh me pa kur kalon pranë sajë.

z.Besnik Seferi: Faleminderit drejtoresh për informatën. Sa e di është duke u punuar për një Autoambulancë, pyetja është deri ku keni arritur? Dhe pyetja e dytë si qëndron puna me mbajtjen e orëve të kujdestarisë të farmacive?

znj.Adelina Beqaj: Për sa i përket Autoambulancës, nuk është ble, sepse vjet i kemi miratuar mjetet financiare dhe i kemi shut edhe disa mjete tjera shtesë, prandaj po pyes pse nuk është ble Autoambulanca?

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS: Për sa u përket ushtruesit të detyrës keni të drejtë, mirëpo der isa të zgjidhen drejtorët duhet patjetër me shku me ushtruesit e detyrës. Në QPS-ë nuk kemi përgjegjës sipas sistematizimit. Aty kemi tani një ushtrues të detyrës i cili i ushtron të drejtat dhe përgjegjësitë që dalin sipas ligjit. Sa i përket sistemit informativ shëndetësor, ka telashe në të gjitha komunat e Kosovës, e as ne nuk bëjmë përjashtim. Material higjienik ka mjaftueshëm. Për furnizim me barna ende nuk kemi lidhë kontratë por jemi të furnizuar mirë me medikamente. Sa i përket blerjes së Autoambulancës, kemi problem për arsye se Përmbartuesi na i ka marrë mjetet financiare. Te Davidovci në dokument është bërë një gabim teknik, e i cili do të përmirësohet. Për sa i përket QMF-së në fshatin Pjetërshicë, do ta kemi parasysht. Për sa i përket kujdestarive të Barnatoreve ne e kemi rregulloren për orarin e Barnatoreve, mbetet që inspektorati ta kryej punën e vetë. Mund të ju njoftoj se në QKMF-ë tani më e kemi Mamografin e përhershëm që funksionon mire, e që mendoj se nuk është pak, sepse jemi kritikuar shpesh herë.

Pika 8

Pyetje - Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj: Nuk mora përgjigje për ushtruesit e detyrës. Shëndetësia është një katrohurë për pjesën e Karitasit. Pyetje për DSHP-në, pse po mungon ndriqimi në fshatin Belinc? Nuk po dua me diskutuar për shkak të presionit të kohës.

z.Asllan Beqaj: Unë po propozoj një pauzë, të vijmë drejtorat, me qëllim që ne ti bëjmë pyetjet.

z.Përparim Ramusa: E përkrahu propozimin e parafolësit, që ta marrim një pauzë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Shkojmë pra në pauzë dhe kthehemi në mbledhje në ora 13:30h.
(Pauza)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Seancën e vazhdojmë në ora 13:31h.

z.Reshat Mujota: Ne po bëjmë pyetje por përgjigjet nuk po i marrim. Pyetje për DPUKLGJ-në, Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, e ka bërë një kërkesë të DPUKLGJ-ja e këta e kanë qu të DSHP-ja për rregullimin e trotuarit të shtëpijat e tij, sepse aty janë pre 15m² asfalt dhe nuk ka siguri në atë pjesë, kabloja e rrymës është bërë aty me një izolim të thjeshtë e që po paraqet rrezik, kur do të rregullohet? Unë nuk pajtoj me konstatimin e Kryetarit se ne po bëjmë politikë me fshatin Rashincë. Po deklarohem publikisht se jamë në përkrahje të banorëve të fshatit Rashincë sa i përket ujësjellësit.

z.Muhamet Ademaj: Pyetje për DZHE-në, në Lagjen "Ademaj" është filluar rregullimi i rrugës në këtë Lagje, pse nuk është përfunduar kjo rrugë?

znj.Adelina Beqaj: Po kërkoj që të përsëriten 2 pyetjet nga mbledhja e kaluar. Pyetje e re për DSHP-në, Çka po ndodhë me pengesat në rrugën e Petrovës?

z.Përparim Ramusa: Për problemin e Rashincës u dhanë disa sçarime, me far arsye Kryetar i more asambleistat e Vetvendosjes dhe i kërcënove. Ti nuk ke biseduar paraprakisht me banorët e Rashincës për ujin, kështu që banorët i ke kundër. Nuk duhet me ua imponu projektin.

z.Asllan Beqaj: Për diskutuesin paraprak mund të them se mua nuk më ka kërcënuar askush dhe as nuk bëhet fjalë asnjëher për këto siq po thua ti kërcënime. Pyetje për DPUKLGJ-në, kur do të

rregullohet kanali i ujrave atmosferik te rruga "Beqa" në Petrovë? Dhe a ka me u vazhdu edhe kanali atmosferik i rrugës dhe trotuari në atë pjesë

z.Rexhep Gashi: Nga 24 pyetje të bëra vetëm në 4 janë përgjigjur drejtorat. A po i ikin përgjegjësisë a çka? Pyetje për DPUKLGJ-në, drejtor shqetësimi im është se po asfalttohen shumë rrugë e ato kanë nevojë edhe për kanalizim, pse nuk po bëhet kanalizimi një her e pastaj asfalttimi? Pyetje për DPUKLGJ-në, i kemi 9 banesa te ndërtesa kolektive e banimit "Fitorja" pse nuk po i ndani këto banesa?

z.Besnik Seferi: Pyetje për DPUKLGJ-në, lidhur me pyetjen e dytë të mbledhjes së kaluar që ka të bëjë me rregullimin e rrugës magjistrale Belinc-Carralevë, çka është ndërmarrë për ta eliminuar rrezikun në lokacionin ku është dëmtuar rruga? Pyetje për drejtorin që është këtu, kush merr qira për antenën e vendosur në pullazin e ndërtesës para Komunës?

Pyetje për DSHP-në, a ka ndonjë takim të përbashkët me KRM "Pastërtia" Njësia në Shtime, për diskutimin lidhur me lokacionin e vendosjes së tyre? Pyetje për DPUKLGJ-në, ku jemi me projektin e realizimit të projektit të kanalizimit rreth 50 metra te rruga "Xhemshir Xhemshiri" në fshatin Petrovë, më saktësisht te lagja Hysenaj?

Pyetje për DPUKLGJ-në, a është në plan të realizohet projekti i kanalizimit në Lagjen e Pajtimit, duke marrë parasysh se është diskutuar shumë gjatë?


z.Muhamet Ademaj: Pyetje për Kryetarin, për një zgjidhje afatgjate të ujit të pijes a ka mundësi që të realizohet një akumulues i ujit në fshatin Carralevë?

znj.Zejniye Veliu: Pyetje për DSHP-në, në rrugën "Sefë Kosharja" nevojitet të vendoset një pasqyre e rrugës, kur do të vendoset? Pyetje për DSHP-në, në rrugën "Islam Neziraj" të vendoset një shenjë e komunikacionit për ndalimin e qarkullimit të automjeteve të rënda, me arsyetimin se kjo rrugë kalon afër shkollës "Bajram Curri" pralelja ne Mollopolc e cila paraqet rrezik?

Kryetari, z.Qemaj Aliu: Po besoj që tani jemi në interpretim direkt me qytetarë, sepse jam këtu për ti scharuar disa dilema që janë ngritur nga anëtarët e Kuvendit, sikurse është çështja e druve nëpër shkollë, kinse në shkollat tona nuk ka dru për ngrohje mjaftueshëm. E vërteta është se ne kemi pas disa shqetësime për sa i përket lidhjes së kontratës. Fatmirësisht rezervat e druve nga vitet e kaluara na kanë mjaftuar që ne me pas dru mjaftueshëm, ndërsa tash kjo çështje është zgjidhur përfundimisht. Çështja e drejtorëve në institucionet lokale ne kemi thënë se do ti depolitizojmë, kështu që çdo drejtor i zgjedhur deri tani është apolitik. Me neve ka marrë fund koha e militantëve partiakë, ashtu siç ka ndodhur në kohën kur kanë qeverisur opozita e tanishme. Për gropën që është bërë në rrugën magjistrale Belinc-Carralevë, siç e dini kjo rrugë është nën menaxhimin e Ministrisë në nivelin qendror, dhe mund të them se përkundër përpjekjeve tona me shkresa për ta njoftuar Ministrinë, ende nuk është rregulluar, por jam i bindur se shumë shpejt do të rregullohet. Diga e ujëmbledhësit të Carralevës është projekt Kombëtar, kjo nuk fillon para 8 viteve. Më shpejt do të ndodhë diga e Firajës, e cila mund të fillojë brenda 2-3 viteve. Kjo është zgjidhje afatgjate për furnizim të mjaftueshëm me ujë për pije për Komunën e Shtimes. Qeverisja jonë ka investuar rreth 3 milion euro në ujin e pijes. Banorët e Rashincës e dinë fort mirë se kush investon në fshatin e tyre qoftë për furnizim me ujë qoftë për projekte të tjera infrastrukturore. Unë jam zotuar para banorëve të fshatit Rashincë se nëse ndodhë shterrimi i puseve të tyre për arsyen e puseve të ujësjellësit. Atëherë unë vet do ta ndali rubinetin e ujit të ujësjellësit. Ne jemi të përkushtuar për punë dhe vepra e jo për fjalë boshe. Sot para pak minutave e nënshkruajta Kontratën për ndërtimin e objektit të ri të Komunës së Shtimes.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Meqenëse diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e Kuvendit e përfundoj në ora: 14:15h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Nr. Prot: 01/408

Datë: 17.12.2024

Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës – Shtime Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	Zyrës së Kuvendit
Nga/Od/From:	Drejtoria për Administratë të Përgjithshme Drejtori, z.Valon Januzi
Lënda/Predmet/Subject:	PROPOZIM-VENDIM për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planit për Integritet Npi-01/157 dt. 27.04.2023

Të nderuar antarë të kuvendit të komunës së Shtimes,

Bazuar në nenin 12.2. shkronja (d), nenin 58 shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Si dhe Bazuar në Ligjin Nr.08/L-017, për Agjensinë për Parandalimin e Korrupsionit, Kuvendit të Komunës së Shtimes i paraqesim për miratim këtë:

PROPOZIM-VENDIM

për anulimin e Vendimit Npi-01-156 dhe Planit për Integritet Npi-01/157 dt. 27.04.2023

Kuvendi i Komunës së Shtime në mbledhjen e -XII- të rregullt për vitin 2024 të mbajtur më:
____.12.2024, _____ miratoi vendimin për anulimin e:

1. VENDIM për miratimin e Planit Komunal për Integritet 2023-2027, Npi-01/156 dt.27.04.2023, dhe
2. PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET 2023-2027, Npi-01/157 dt.27.04.2023,

Arsyetim: Plani për Integritet është harmonizuar me obligimet strategjike të përcaktuara me Ligjin e ri Nr.08/L-017, dhe si rrjedhojë do të ndryshohet Plani Komunal për Integritet. Me Planin e Ri të Integritetit, bazuar në Ligjin e ri, Plani për Integritet kalon përmes Ekzekutivit pa pasur nevojë që të votohet në Kuvend.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Nr. Prot: 02/ 1346

Datë: 17.12.2024

Për/Za/To:	Kuvendi i Komunës – Shtime Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Zyra e Kryetarit, Kryetari, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject:	Propozi-Vendim për plotësim-ndryshim e vendimit Npi- 01-291 dt. 27.09.2022 për KKS

Të nderuar antarë të kuvendit të komunës së Shtimes.

Bazuar në nenin 58 pikat (g,h) të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës") Nr. 28/2008); Nenin 7 të Ligjit për Policinë e Kosovës Nr.04/L-076, si dhe neni 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/20/2012 MPB dhe U.A-03/2012 MAPL, për këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës së Shtimes miratoi:

PROPOZIM- VENDIM

PËR NDRYSHIM-PLOTESIMIN E VENDIMIT TE KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKS)

I

Kuvendi i Komunës së Shtime në mbledhjen e -XII- të rregullt për vitin 2024 të mbajtur më: 17.12.2024, miratoi Vendimin për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi- 01/291 të datës 27.09.2022 për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në përbërje si vijon:

1. Qemajl AliuKryetar i Komunës së Shtimes.
2. Haxhi BehluliKomandant i Policisë – Shtime.
3. Gzim Morina.....Përfaqësues nga Forca e Sigurisë të Kosovës.
4. Skender BaftiuKryetar i KBI, dhe Imam i Xhamisë – Shtime.
5. Skender Dauti.....Përgjegjës i Zyrës për Mbrojtje dhe Shpëtim.
6. Bajram Gashi.....Komandant i njësisë profesionale për zjarrfikje dhe shpëtim.
7. Yllka Fejzullahu.....Drëjtore dhe Drejtore për Arsim,
8. Reshat Gashi.....Kordinator për të Drejtave të Njeriut dhe Barazi Gjinore.
9. Muhamet Mehmeti.....Zyrtar për të drejta dhe integritet të komuniteteve në (ZKKK).
10. Arton DemiriPërfaqësues i Komunitetit Rom.
11. Xhavit Bungu.....Përfaqësues i Prindërve të shkollave në Komunën e Shtimes.
12. Shpresim Mahmuti.....Përfaqësues nga OJQ " Rinova" Shtime,
13. Albert Ramadani.....Përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike.
14. Muhadin Halili.....Përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Data/Datum/Date:	17.12.2024
Nr./Br./No	02/ 1349
Për/Za/To:	Kryesuesin e Kuvendit, z. Adnan Ademi; Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject:	Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II-të i punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Shtimes;

Në mbështetje të nenit 58, pika "j" e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale paraqesim Raportin e përgjithshëm i 6-mujor të II-të të Punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes.

Raporti i përgjithshëm i 6-mujorit të II-të të punës së ekzekutivit në Komunën e Shtimes ofron një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve dhe arritjeve gjatë gjashtë muajve të fundit. Ky raport përfshin progresin në projekte të rëndësishme infrastrukturore, si dhe investimet në fusha kyçe si arsimi, shëndetësia, bujqësia, zhvillimi ekonomik.

Vlerësojmë se ky raport pasqyron një vit të begatë me projekte të shumta dhe të suksësishëm në Komunën e Shtimes. Me angazhimin e të gjithë ekipit dhe mbështetjen e vazhdueshme, kemi arritur të realizojmë një sërë projektesh të rëndësishme dhe të përmirësojmë cilësinë e jetësës për qytetarët tanë. Raporti do të shërbejë si bazë solide për diskutime dhe vendime të ardhshme që do të çojnë drejt një të ardhmeje edhe më të ndritur për Komunën e Shtimes.